



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit  
Institucija Ombudsmana - Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. KPD1133325  
Nr. i fqj/Br.str/Nr.pg.  
Data/Datum/Date: 07/08/2025

PRISHTINË - PRIŠTINA - PRISTINA II



Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosovo  
Institucion i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

## OPINION

### I

### AVOKATIT TË POPULLIT

në lidhje me

të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarries të zyrtarëve publikë në Administratën Tatimore të Kosovës

Për: Z. Ilir Murtezaj, u.d. drejtor i përgjithshëm  
Administrata Tatimore e Kosovës

Prishtinë, më 7 gusht 2025

## Qëllimi

Ky Opinion ka për qëllim të shprehë pikëpamjet e Avokatit të Popullit, nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, lidhur me të drejtat zgjedhore dhe të drejtën e pjesëmarries në jetën publike të zyrtarëve të Administratës Tatimore të Kosovës, përkatësisht të drejtën e tyre për të kandiduar në zgjedhjet lokale.

## Kompetenca e Avokatit të Popullit

1. Kushtetuta e Republikës së Kosovës (më tej: Kushtetuta), në nenin 132, paragrafi 1, përcakton: “*Avokati i Popullit mbikëqyrë dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*” Kurse në paragrin 3 përcakton: “*Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua rë ne pajtim me ligj.*”
2. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjera, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

“*Të térheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tillë.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 1.2).

“*Të njoftojë Qeverinë, Kuvendin dhe institucionet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 5).

“*T'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 6).

“*Të rekomandojë nxjerrjen e ligjeve të reja në Kuvend, ndryshimin e ligjeve që janë në fuqi dhe nxjerrjen apo ndryshimin e akteve nënligjore dhe administrative nga institucionet e Republikës së Kosovës.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 7).

“*Të përgatisë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryejë hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 8).

“*T'i rekomandojë Kuvendit harmonizimin e legjislacionit me standarde ndërkombëtare për të drejtat dhe liritë e njeriut si dhe zbatimin e tyre efektiv.*” (Neni 18, par. 1, nënpar. 9).

“*Avokati i Popullit mund të paraqitet në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, çështjet e barazisë dhe mbrojtjes nga diskriminimit.*” (neni 16, parografi 9)

3. Me dërgimin e këtij Opinionit tek institucionet kompetente dhe me publikimin e tij, Avokati i Popullit synon të përmbrushë përgjegjësitë e tij kushtetuese dhe ligjore të përmendura më sipër.

## Përshkrimi i çështjes

4. Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, pranoi ankesë nga J. M. (në tekstin e mëtejshmë: ankuesi), parashtruar kundër Administratës Tatimore të Kosovës (ATK).
5. Bazuar në pohimet e ankuesit dhe në dokumentacionin që ka në dispozicion Institucioni i Avokatit të Popullit, rezulton se më 21 korrik 2025, ankuesi, përmes postës elektronike, iu drejtua udhëheqësit të Divisionit të Standardeve Profesionale në ATK, me kërkesë për një dëshmi institucionale që vërteton se ai nuk ka ndalesa ligjore, sipas legjislacionit tativor në fuqi, që do t'i pamundësonin kandidimin në zgjedhjet lokale të tetorit 2025.
6. Më 21 korrik 2025, ankuesi mori përgjigje nga udhëheqësi i Divisionit të Standardeve Profesionale, me të cilën u njoftu: "*Divizioni i Standardeve Profesionale nuk është kompetent të ju lëshoje ketë dëshmi apo dokument si keni kërkuar. Për me shume mund te konsultohuni me Divisionin e Burimeve Njerëzorë apo me Departamentin e Shërbimeve Juridike.*"
7. Bazuar në pohimet e ankuesit dhe në shkresat e lëndës, më 24 korrik 2025, udhëheqësi i Divisionit të Standardeve Profesionale, përmes u.d. drejtorit të përgjithshëm të ATK-së, përcollti një qarkore te stafi i ATK-së, me të cilën ua rikujtoi atyre se obligohen t'i respektojnë dispozitat e nenit 10 të Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes, duke marrë për shkas zgjedhjet lokale që do të mbahen më 12 tetor 2025.
8. Avokati i Popullit vërejti se në këtë Qarkore theksohet: "*Duke qenë se jemi në prag të fushatës për zgjedhjet lokale, të cilat mbahen më 12 tetor 2025, ju rikujtojmë se jeni të obliguar të respektoni dispozitat e nenit 10 të Kodit të Etikës Mirësjelljes, konkretisht:*
  - *Paragrafi 2: Nivelet drejtuese(të larta, të mesme dhe të ulëta)nuk kanë të drejtë të jenë anëtarë të partive politike dhe nuk mund të jenë anëtar të organeve qendrore drejtuese qendrore apo komunale të ndonjë partie politike*
  - *Paragrafi 3: Zyrtari i ATK-së duhet të ushtrojë funksionin e tij në mënyrë të pavarur. Vendimet dhe veprimet e tij nuk duhet të kenë karakter diskriminues apo favorizues ndaj tatimpaguesve apo qytetarëve. Nuk lejohet asnjë premtim apo përdorim i autoritetit të ATK-së, për të mbështetur apo penguar ndonjë subjekt politik apo individ.*
  - *Paragrafi 4: Zyrtarët e ATK-së nuk duhet të marrin pjesë në asnjë aktivitet politik, që mund të rrezikojë ose që perceptohet se rrezikon paanësinë e tyre profesionale*
  - *Paragrafi 5: Nivelet drejtuese ndalojen të marrin pjesë në aktivitete politike dhe fushata të organizuara nga partitë politike.*
9. Për më tepër, në këtë Qarkore thuhet se "[...] pjesëmarrja e zyrtarëve të ATK-së në aktivitete politike apo kandidimi në zgjedhje përbën shkelje të nenit 10 të Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e Administratës Tatimore të Kosovës". Ndërsa, duke i referuar nenit 9, paragrafit 9.2, të Ligjit nr.03/L072 për Zgjedhjet Lokale, theksohet se zyrtarët e ATK-së nuk mund të certifikohen nga KQZ-ja.

## Vlerësimi i Avokatit të Popullit

10. Avokati i Popullit vërejti se Kushtetuta e Republikës së Kosovës (në vijim: Kushtetuta), në nenin 45, paragrafi 1, përcakton: "*Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe*

*të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor.” Ndërsa paragrafi 3 i këtij nenit obligon institucionet shtetërore të “mbështesin mundësitetë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike”.*

11. Sipas nenit 22 të Kushtetutës: “*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.*” Në lidhje me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit përcaktohet se “*të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut*”.
12. Ligji Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës (në vijim: Ligji për Zgjedhjet Lokale), në nenin 3 [Parimet Themelore] përcakton parimet themelore, përbajtjen dhe administrimin e zgjedhjeve lokale, ndërsa në paragrafin 3.1 përcakton: “*Çdo qytetar i Kosovës ka të drejtë për të votuar dhe të zgjidhet pa diskriminim në bazë të racës, etnisë, ngjyrës, gjuhës, gjinisë, besimit fetar apo bindjes politike, arsimit, përkatesisë sociale apo ndonjë kriteri tjetër të ngjashëm në përputhje me dispozitat e këtij ligji.*” Po ashtu, në paragrafin 3.2 përcakton: “*Kryetari i Komunës dhe anëtarët e Kuvendit Komunal, nuk mund të jenë anëtarë të asnë organi tjetër të zgjedhur.*”
13. Më tej Avokati i Popullit vërejti se Ligji nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në nenin 6 [Nëpunësja/i civil me status të veçantë] kategorizon të punësuarit në ATK si nëpunës civilë me status të veçantë: “[...] 1.7. të punësuarat/it në Administratën Tatimore të Kosovës; [...].”
14. Ligji nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, në nenin 25 [Të drejta Politike] përcakton të drejtën për pjesëmarrje politike të zyrtarëve publikë:
  - “*1. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të marrë pjesë në aktivitete politike dhe të shprehë bindjet partiake vetëm jashtë orarit zyrtar të punës dhe jashtë ambienteve të institucionit publik.*
  - “*2. Nëpunësja/i civil me përjashtim të nëpunëses/it civil të kategorisë së nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues, mund të jenë anëtarë/ë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë/ë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të një partie politike.*
  - “*3. Nëpunësja/i e shërbimit publik dhe nëpunësja/i teknik dhe mbështetës mund të jenë anëtarë/ë të partive politike dhe anëtarë/ë të organeve drejtuese të një partie politike, me përjashtim të nëpunëses/it së shërbimit publik të nivelit të lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues, të cilët mund të jenë anëtarë/ë të partive politike, por nuk mund të jenë anëtarë/ë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të një partie politike.*
  - “*4. Zyrtarja/i publik ka të drejtë të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Kosovës apo për organet komunale, përvèç kur përcaktohet ndryshe me ligj.*
  - “*5. Zyrtarja/i publik, e cila kandidon për zgjedhjet qendrore ose lokale, duhet të pezullojë pa pagesë vendin e punës shtatë (7) ditë para periudhës së hapjes zyrtare të*

*fushatës. Pezullimi përfundon pesë (5) ditë pas mbylljes zyrtare të fushatës.*

6. Në rast të zgjedhjes në Kuvendin e Republikës së Kosovës, zyrtarja/i publik, i cila pranon mandatin, pezullon marrëdhënien e punës prej datës së certifikimit të zgjedhjes së kandidatit deri në përfundim të mandatit përkatës, përjashtimisht stafit akademik universitar (profesore/i i/e rregullt, profesore/i i/e asociuar, profesore/i asistent, profesore/i, ligjërues/e, asistent/e) dhe profesionistëve shëndetësor.

7. Përjashtimisht, pezullimi në kuptim të paragrafit 6. të këtij neni, nuk mund të bëhet për pozitat të cilat janë me mandat.

8. Pas përfundimit të mandatit si i zgjedhur sipas paragrafit 6. të këtij neni, zyrtares/it publik i garantohet marrëdhënia e punës në institucionin ku ka qenë në marrëdhënie pune ose në një institucion tjeter, në pozitë të njëjtë ose ekuivalente, me kusht që plotëson kriteret për caktimin në pozitën në fjalë.”

15. Për sa i përket së drejtës për kandidim në zgjedhje, të gjithë zyrtarët publikë, përfshirë ata të ATK-së, kanë të drejtë të kandidojnë dhe të zgjidhen në zgjedhjet parlamentare apo komunale, përveç rasteve kur ndalohet me ligj specifik. Ligji për Procedurat Tatimore nuk ndalon në mënyrë të qartë kandidimin, por zyrtarët që synojnë të kandidojnë duhet të respektojnë pezullimin e detyrueshëm.

16. Në rastet kur zyrtari publik zgjidhet në Kuvend ose në organ komunal dhe pranon mandatin, atëherë pezullohet marrëdhënia e punës deri në fund të mandatit politik. Përjashtimisht, pezullimi në kuptim të paragrafit 6. të këtij neni nuk mund të bëhet për pozitat drejtuese me mandat. Në këto raste, personat që mbajnë pozita drejtuese me mandat duhet ose të japid dorëheqje nga pozita me mandat, për të ushtruar funksionin politik, ose të refuzojnë pranimin e mandatit politik, nëse dëshirojnë të vazhdojnë të ushtrojnë detyrën në pozitën me mandat.

17. Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut, të drejtat zgjedhore dhe e drejta e përfaqësimit janë thelbësore për demokracinë dhe zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë. Këto të drejta janë të mbrojtura dhe të garantuara për çdo qytetar të Republikës së Kosovës që ka mbushur moshën 18-vjeçare. Përmes garantimit të së drejtës për të votuar, secilit i garantohet e drejta për t'u zgjedhur, përjashtimisht nëse kjo e drejtë kufizohet me vendim gjyqësor.

18. Avokati i Popullit vërejti se Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNj)<sup>1</sup>- Protokoli Nr. 1 i KEDNj-së – Neni 3: E drejta për zgjedhje të lira, përcakton:

*“Palët Kontraktuese angazhohen të organizojnë, brenda një periudhe të arsyeshme, zgjedhje të lira, në mënyrë të fshehtë, nën kushte që sigurojnë lirinë e shprehjes së opinionit të popullit në zgjedhjen e trupit ligjvënës.”*

19. Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (në vijim: PNDCP)<sup>2</sup>

Neni 25 – Të drejtat politike

*“Çdo qytetar do të ketë, pa asnjë diskriminim dhe pa kufizime të paarsyeshme, të drejtën dhe mundësinë:*

<sup>1</sup> Shih në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73773>

<sup>2</sup> Shih në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=73770>

- (a) të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, drejtpërdrejt ose përmes përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) të votojë dhe të zgjidhet në zgjedhje periodike dhe autentike, që do të zhvillohen me votim të fshehtë dhe që do të sigurojnë shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) të ketë akses, në kushte të përgjithshme të barazisë, në funksione publike në vendin e vet."

20. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit analizoi Opinionin nr. 190/2002 të Komisionit Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), i cili thekson rrethanat në të cilat mund të përjashtohen individët nga e drejta për të votuar dhe për t'u zgjedhur.<sup>3</sup> Dispozitat për privimin e individëve nga këto të drejta mund të miratohen vetëm nëse plotësohen kushtet: është e parashikuar me ligj; nëse respektohet parimi i proporcionalitetit; kushtet për privimin e individëve nga e drejta për t'u zgjedhur mund të jenë më pak strikte sesa kushtet për privimin e tyre nga e drejta për të votuar; privimi mund të aplikohet në rastin e paftësisë mendore ose të dënimit nga gjykata për një veprë të rëndë penale; abrogimi i të drejtave politike ose përcaktimi i paftësisë mendore mund të aplikohet vetëm me vendim të posaçëm gjykate.
21. Për më tepër, Avokati i Popullit rikujton se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ndjek një model të veçantë të pranimit të disa prej marrëveshjeve dhe instrumenteve kryesore ndërkombëtare për liritë dhe për të drejtat e njeriut (përfshirë Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut; Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj; Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj etj.) duke i listuar ato në nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], ku parashihet: "*Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike [...].*" Mbi këtë bazë, edhe dispozitat e këtyre dokumenteve për të drejtën për t'u zgjedhur dhe për t'u zgjedhur [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes] janë burime primare për të gjitha vendimet e organeve publike në Kosovë, me qëllim të zbatimit praktik të këtij parimi.
22. Përveç përcaktimit se aktet ndërkombëtare të lartpërmendura janë të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë, në lidhje me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, Kushtetuta përban edhe një dispozitë të posaçme që e definon këtë parim, ku në nenin 45 përcaktohet: "*Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. 3. Institucionet shtetërore mbështesin mundësitet për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.*"


<sup>3</sup> Strasburg, 30 tetor 2002 cdl-ad (2002) 23 rev or. Fr. Opinion nr. 190/2002 Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Kodi i praktikës së mirë në çështjet zgjedhore - udhëzime dhe raporti shpjegues i miratuar nga Komisioni i Venecias në mbledhjen e tij 52-të plenare (Venecia, 18-19 tetor 2002).

23. Mbi këtë bazë del se e drejta për të kandiduar në zgjedhje vlen derisa nuk është parashikuar ndryshe me ligj dhe nëse respektohet parimi i proporcionalitetit; kushtet për privimin e individëve nga e drejta për t'u zgjedhur mund të jenë më pak strikte sesa kushtet për privimin e tyre nga e drejta për të votuar; privimi mund të aplikohet në rastin e paaftësisë mendore ose të dënimit nga gjykata për një veprë të rëndë penale; abrogimi i të drejtave politike ose përcaktimi i paaftësisë mendore mund të aplikohet vetëm me vendim të posaçëm gjykate.
24. Në lidhje me nenin 10 të Kodit të Etikës dhe Mirësjelljes për zyrtarët e ATK-së dhe të drejtën për t'u zgjedhur, Avokati i Popullit vëren se ky nen nuk e ndalon në mënyrë të qartë (eksplicite) ushtrimin e kësaj të drejte. Përkundrazi, dispozita e nenit 10 vends dytirime të natyrës etike dhe profesionale për zyrtarët, duke kërkuar ruajtjen e paanshmërisë dhe ndalimin e përdorimit të funksionit zyrtar për qëllime politike. Prandaj, sipas këtij neni, e drejta e punonjësit të ATK-së për t'u zgjedhur nuk ndalohet.

#### Përfundim

25. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh rrrethanat e theksuara më sipër, konsideron se e drejta zgjedhore dhe e pjesëmarjes përcaktohet në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.
26. Në fryshtë e përcaktimëve kushtetuese, Avokati i Popullit konsideron se edhe Ligji nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë përcakton dispozita, sipas të cilave zyrtarëve publikë u njihet e drejta e kandidimit për zgjedhjet qendrore dhe lokale, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj. Në këtë drejtim, ligji përcakton edhe procedurën e cila duhet të respektohet nga zyrtarët publikë, kur vodosin të kandidojnë në zgjedhjet qendrore apo lokale.
27. Për më tepër, Avokati i Popullit analizoi Ligjin nr. 08/L-257 për Administrimin e Procedurave Tatimore dhe konsideron se nuk ka ndonjë dispozitë në ligj, përmes së cilës punonjësve të ATK-së u ndalohet e drejta e kandidimit për zgjedhjet qendrore apo lokale.
28. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit thekson se Ligji për Zyrtarët Publik dhe Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore bartin krejtësisht fryshtë normuese të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.
29. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh përcaktimet në Opinionin nr.190/2002 të Komisionit të Venecias, thekson se edhe Komisioni barti të njëjtin qëndrim sikurse Kushtetuta dhe ligjet e theksuara më sipër, përkatësisht përcaktoi se ndalesa e kandidimit mund të bëhet vetëm me ligj ose me vendim gjykate. Pra, nuk ka një ndalesë tjetër, e cila mund t'u shqiptohet punonjësve lidhur me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarjes.
30. Avokati i Popullit konsideron se edhe Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes për Zyrtarët e ATK-së bart fryshtë normuese të përcaktuara në Ligjin për Zyrtarët Publik, për sa i përket së drejtës për të qenë anëtarë të partive politike dhe anëtarë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të partive politike, duke e kufizuar këtë të drejtë për nivelin e lartë, të mesëm dhe të ulët drejtues, të cilëve shprehimisht u ndalohet mundësia për të qenë anëtarë të partive politike si dhe anëtarë të organeve drejtuese qendrore dhe komunale të partive politike.
31. Sipas përcaktimëve në nenin 10 të këtij kodi, Avokati i Popullit nuk vërejti që ndonjë dispozitë e ndalon të drejtën e kandidimit të zyrtarëve të ATK-së, për zgjedhjet qendrore dhe lokale.

32. Avokati i Popullit konsideron se po të kishte një ndalesë të tillë në kod, atëherë ajo dispozitë do ishte në kundërshtim me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik.
33. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se nuk ka ndonjë dispozitë në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Ligjin për Zyrtarët Publik apo në Ligjin për Administrimin e Procedurave Tatimore, që e ndalon kandidimin e zyrtarëve të ATK-së, për zgjedhjet qendrore apo lokale në Republikën e Kosovës.
34. Në fund, Avokati i Popullit vlerëson se është obligim i secilit institucion të Republikës së Kosovës, duke përfshirë edhe Administratën Tatimore të Kosovës, që kur nxjerrin rregulla që prekin të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të kenë parasysh të drejtën që përcaktohet me nenin 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe dispozitat e Ligjit për Zgjedhjet Lokale, si dhe dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publik, që rregullojnë të drejtën e zyrtarëve për të kandiduar në zgjedhjet qendrore dhe lokale në Republikës e Kosovës.



Me nderime,  
Naim Qelaj  
Avokat i Popullit